
POSTIM ARKIVOR

Revolucioni Hungarez i vitit 1956 dhe jehona e tij në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit



SEKSIONI

Organizata Kundër Regjimit

PERIUDHA

1955 - 1956

Revolucioni Hungarez i vitit 1956 ishte një kryengritje popullore kundër regjimit komunist dhe kontrollit sovjetik, që nisi më 23 tetor dhe u shtyp nga ndërhyrja ushtarake sovjetike në nëntor të po atij viti. Ngjarjet frymëzuan thirrje për liri dhe qëndresë edhe përtej kufijve të Hungarisë. Një dëshmi e kësaj jehone gjendet në dosjen hetimore-gjyqësore nr. 8676-A, të Fondit nr. 1 të ish-Sigurimit të Shtetit, ku dokumentohen traktet e lidhura me çështjen e Nikolin Pavacit, Ndrekë Bazhdarit dhe Karlo Cefës. Në një prej tyre, të përshkruar në faqen 38 të dosjes, shkruhet: “Lavdi Heronjve Martirë Hungarezë”, krahas thirrjeve për liri dhe parullave kundër diktaturës. Ky dokument tregon se jehona e Revolucionit Hungarez u pasqyrua edhe në materialet që u trajtuan nga organet hetimore dhe gjyqësore të regjimit komunist shqiptar.

PERMBAJTJE #1


Dënimi i Nikolin Pavacit, Ndrekë Bazhdarit dhe Karlo Cefës për hartimin dhe shpërndarjen e trakteve kundër regjimit komunist (1957)

Dosja Hetimore-Gjyqësore nr. 8676-A, pjesë e Fondit nr. 1, përbëhet nga 201 faqe dhe lidhet me procedimin penal ndaj Nikolin Pavacit, Ndrekë Bazhdarit dhe Karlo Cefës, të akuzuar për tentativë arratisjeje jashtë shtetit dhe agjitacion e propagandë, sipas neneve 10, 64 dhe 72 të Kodit Penal. Dokumentacioni përfshin procesverbale hetimore, vendime gjyqësore, akte ekspertize grafike, fotografi dorëshkrimesh, rekurse ankimimi, pretencën e prokurorit dhe urdhrin për arrest-kontrollin. Në dosje gjenden të dhëna mbi hartimin dhe shpërndarjen e trakteve me përmbajtje kundër regjimit komunist, të cilat përmbanin thirrje për liri, solidaritet dhe qëndresë, si dhe parulla në mbështetje të zhvillimeve politike në Hungari, Poloni dhe Jugosllavi. Në procesverbalin e marrjes në pyetje të Nikolin Pavacit, në faqen 38, përshkruhet përmbajtja e trakteve dhe roli i Ndrekë Bazhdarit në shkrimin e tyre. Ndërsa, në aktin e ekspertizës grafike, në faqen 119, konkludohet se trakti i shqyrtuar ishte shkruar nga Ndrekë Bazhdari. Një prej trakteve ruhet në faqen 121 të dosjes. Sipas dokumentacionit, Nikolin Pavaci u dënua me 16 vjet burgim, Karlo Cefa me 12 vjet burgim dhe Ndrekë Bazhdari me 14 vjet burgim, si dhe me konfiskimin e pasurisë. Në faqen 181 ndodhet vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake, datë 14.09.1957, që konfirmonte vendimin nr. 103, datë 06.08.1957, për dënimin e të tre personave. Dokumentacioni paraqet një dëshmi arkivore mbi ndjekjen penale dhe dënimin e tre shtetasve në vitin 1957, duke evidentuar mënyrën se si veprimtaria e lidhur me hartimin dhe shpërndarjen e trakteve kundër regjimit u trajtua nga organet hetimore dhe gjyqësore të kohës.

MEDIA #1

Procesverbal i marrjes në pyetje të Nikolin Povaçit lidhur me hartimin e trakteve kundër regjimit komunist, 4 nëntor 1957

MEDIA FAQE #1



-33-

P R O C E S - V E R B A L

I mbajtur sot me daten 4/III/1957, prej mejo Major Hysen Hoxhati, ne zyren e Drejtoris P.Mbrendshme mbi deponimet e te dqiturit ne arres se Nikolin Povaçit nga qyteti i Shkodres.- - - - - - - - -
Pyetje fillon n'ore_____
Pyetje mbaron ore_____

Pyetje: Vazhdo te shpjegosh i pandehuri rreth trakteve qe kemi konceptuar dhe ngjitur ne muret e disa godinave ne qytetin e Shkodres.


Pergjigje: Une Nikolini 2-3 dit para se te bej traktet jame mendue se c'fare permbajtje ti benim traktet dhe daten qe i shkruem keto i shkruem beshme me Ndrek Bezhderin,une i flitesha Ndrekes dhe ay i shkruente.Per-mbejtjen e trakteve e kisha nder-mend dhe i shenoja pjese pjese ne leter e duke i gomuluar.Parulle te ndryshme qe mesa i flitesha Ndrekes dhe ay i shkruente ne fjet e letres qe kisha pregadit apostafat per trakte.Une mbaj mende se ne traktet sd una dhe Ndreka kemi shkruar keto parulla.Trakti kishte qysh nga fillimi e deri ne mbarim keto parulla.- - - - - - - -

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Konkluzioni i Aktit të Ekspertizës Kriminalistike mbi Shkrimin e Traktit Kundër-Revolucionar

MEDIA FAQE #1



- 2 - 107. 112

e lidhjet se germave ne fjale, drejtimi i rreshtaven forma e rresh
tave , pjeresija e shkrimit, menyra e lidhjet se fjaleve etj. jane
te perbashketa ne te dy doreshkrimet.

Gjithashtu ne ndertimin e germave ekzistojne karakteristi
ka te perbashketa po thuaj ne te gjitha germat e alfabetit qe
ekzistojne ne tekstin e shkruar. Per pasqyrim shikoni dhe tabellen
fotografike qe i bashkengjitet ketij akti.

Duke u mbeshtetur ne studimin e bere jam i bindur te
perfundoj ne kete

K O N K L U Z I O N:

TRAKTI ME PERMBAJTJE KUNDER REVOLUCIONARE QE PERMENDET
NE KETE AKT ESHTE SHKRUAR NGA I PANDESURI NDREK BAZHDARI.

EKSPERTI KRIMINALIST
Toger (Shefik Haxhiu)

AIDSSH

Konkluzioni i Aktit të Ekspertizës Kriminalistike mbi Shkrimin e Traktit Kundër-Revolucionar

INFORMACION

Konkluzioni i Aktit të Ekspertizës Kriminalistike mbi Shkrimin e Traktit Kundër-Revolucionar

FONDI	1
DOSJA	8686.a
PUNETORI OPERATIV	Shefik Haxhiu


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Trakt Antidiktatorial në Mbrojtje të Revolucionit Hungarez (1956–1957)

MEDIA FAQE #1



Trakt Antidiktatorial në Mbrojtje të Revolucionit Hungarez (1956–1957)

INFORMACION

Trakt Antidiktatorial në Mbrojtje të Revolucionit Hungarez (1956–1957)

FONDI	1
DOSJA	8676.a
LLOJI I DOKUMENTIT	Trakt


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Vendim i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë për Dënimin e Tre Të Rinjve nga Shkodra (1957)

MEDIA FAQE #1



Vendim i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë për Dënimin e Tre Të Rinjve nga Shkodra (1957)

INFORMACION

Vendim i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë për Dënimin e Tre Të Rinjve nga Shkodra (1957)

FONDI	1
DOSJA	8676.a
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim i Kolegjit Ushtarak te Gjykates se Larte
DATË	14/9/1957
GJYKATA	N/Kolonel Mustafa Qilimi
ANËTARËT	Hetem Spiro

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.